

## Ka Buletin tremujor për Projektin e Binjakëzimit „Forcimi i kapacitetit institucional të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në rrugën drejt anëtarësimit të saj në SEBQ“

### ❖ Çfarë ndodhi midis 15 dhjetorit të vitit 2019 dhe 14 marsit të vitit 2020?

Komponenti 1:

#### SHËRBIMET DHE SISTEMET E PAGESAVE

Në tremujorin e dytë të Projektit, u zhvilluan dy misione eksperte.

Në kuadër të aktivitetit të parë „**Forcimi i kapacitetit institucional në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit PPP/FT**“ dy ekspertë nga Banka e Lituanisë prezantuan përvojën e tyre dhe praktikën më të mira të BQE-së dhe bankave tjera qendrore të BE-së lidhur me PPP/FT. Procesi aktual i mbikëqyrjes në terren në fushën e PPP/FT që e zbaton BPRMV-ja u analizua me qëllim identifikimin e mangësive në procesin aktual dhe u dhanë rekomandime përkatëse.

Misioni i dytë u mbajt nga një ekspert i Bankës së Lituanisë, që u fokusua në licencimin e **institucioneve të pagesave dhe institucioneve për para elektronike**. U analizuan dispozitat ekzistuese rregulatore nacionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe procedurat e BPRMV-së lidhur me Direktivën për shërbimet e pagesave 2 me qëllim identifikimin e problemeve në procesin dhe rregullativën aktuale. Temat që u diskutuan gjatë takimeve ishin: Rregulloret e BE-së lidhur me licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve për para elektronike, përfshirë procedurat për licencim, pëlqim për anëtarët e organeve drejtuese, pëlqim për pranimin, refuzim të kërkesave, tërheqjen e licencave dhe procedurat tjera lidhur me licencimin. Përvoja e Republikës së Lituanisë dhe Bankës së Lituanisë lidhur me transpozimin e rregullativave të përmendura të BE-së dhe Udhëzimeve të Autoritetit Bankar Evropian gjithashtu u nda. U sigurua një trajnim për disa aspekte kryesore të procedurave për licencim (përfshirë edhe vlerësimin e modeleve të biznesit, programit të punës, anëtarët e propozuar të organeve drejtuese, aksionarëve, refuzime dhe tërheqje).



Foto 1.

Pas pesë ditësh punë të vështirë në të dy misionet e shkurtit, për komponentët 1 dhe 2, eksperti lituanëz për institucionet e pagesave dhe institucionet e parave elektronike, i cili licencon dhe në mënyrë mbikëqyrëse vlerëson skema të ndryshme të investimeve kolektive në procedurat për licencimin dhe blerjes, z. Karolis Masiliunas me kolegët e Sektorit për Mbikëqyrje dhe Drejtorisë për Sistemet e Pagesave të BPRMV-së në një darkë lamtumire.

Komponenti 2:

#### RREGULLATIVA DHE MBIKËQYRJA E BANKAVE

Në tremujorin e dytë të projektit u mbajtën **tre misione eksperte** në kuadër të këtij komponenti.

Në kuadër të aktivitetit të parë Zhvillimi i kushteve për përmirësimin e pagesës së kredive, **administrimin dhe zgjidhjen e kredive me probleme** dhe administrimin me rreziqet e bankave, misioni u mbajt nga një ekspert i bankës së Greqisë. Situata aktuale u analizua, dallimet u identifikuan dhe u dhanë rekomandime. Misioni përfshiu temat në vijim: Strategji për zgjidhjen e kredive me probleme, pengesa për zgjidhjen e kredive me probleme, palët e pretendimeve dhe ofertës, pengesa strukturore, përvojat themelore dhe mënyrat e administrimit të bankave, roli i politikës makroprudenciale, si dhe trajtimi i shkaqeve për rritjen e kredive me probleme në nivel sistemi.

Misioni i dytë (i zhvilluar nga eksperti i Bankës së Lituanisë) iu dedikua **vlerësimit të skemave të ndryshme të investimit nga aspekti i procedurave për licencim dhe blerjes së aksioneve**. Me anë të prezantimit u dhanë informacione të hollësishme dhe u shqyrtuan çështje lidhur me vlerësimin e aksionarëve me pjesëmarrje të kualifikuar, blerjet specifike si kompani investuese, shoqatat për investim të përbashkët, trustet dhe forma tjera të investimit.


Misioni i tretë u zhvillua nga ana e ekspertëve të Bankës së Holandës dhe Bankës së Gjermanisë, dhe qëllimi përfundimtar ishte **përgatitja e një metodologjie të brendshme për vlerësimin e procesit për përcaktimin e likuiditetit të brendshëm**. Ekspertët fituan njohuri për sistemin bankar maqedonas, si dhe për qasjen mbikëqyrëse për vlerësim të rrezikut të likuiditetit dhe procesit të



përcaktimit të likuiditetit të brendshëm. Mbikëqyrësit (nga jashtë dhe në terren) të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut fituan njohuri mbi procesin e përcaktimit të likuiditetit të brendshëm dhe përfshirjen e tij në procesin e vlerësimit mbikëqyrës të rreziqeve në Holandë dhe mekanizmin e vetëm mbikëqyrës, si dhe mënyrën e realizimit të mbikëqyrjes në terren në Gjermani. Në fund, u përfundua se misioni i ardhshëm do t'i kushtohet vlerësimit të procesit për përcaktimin e likuiditetit të brendshëm i cili për herë të parë këtë vit do të zbatohet nga ana e bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

**Foto 2.**

Ekspertët nga Kroacia, z. Nikola Ljubić Karanović dhe z-nja Srebrenka Gudan, ekspert nga Rumania, z-nja Kamelija Neagu, me përfaqësues nga Njësia për Statistikë të Llogarive Financiare të Drejtorisë për Statistikë, gjatë punës së tyre në misionin e muajit janar për llogaritë financiare të sektorit të institucioneve financiare.



Komponenti 3:

#### **STATISTIKA E LLOGARIVE FINANCIARE**

Në këtë tremujor u mbajt një mision ekspert me ekspertë nga Banka Popullore e Kroacisë dhe Banka e Rumanisë.

Ky ishte misioni në kuadër të aktivitetit „Mbështetje për harmonizimin e mëtejshëm të statistikës së llogarive financiare në BPRMV me standardet e SEBQ/BQE“, **me fokus në llogaritë financiare të sektorit të institucioneve financiare.** Gjatë misionit, ekspertët analizuan gjendjen aktuale dhe dhanë rekomandime për përmirësimin e procedurave për përpilimin e llogarive financiare të sektorit të institucioneve financiare. Ata gjithashtu ndanë përvojën e vendeve anëtare të BE-së lidhur me procedurat e punës për përpilimin e llogarive financiare. Përveç kësaj, sa i përket çështjeve të përmendura u organizua një takim me Entin Shtetëror të Statistikës dhe Ministrinë e Financave.

Komponenti 4:

#### **NJOHURI DHE AFTËSI NË ANALIZËN E POLITIKAVE**

Në tremujorin e dytë të Projektit, në kuadër të këtij komponenti nuk u mbajt asnjë mision.

#### **SHËNIM I RËNDËSISHËM:**

Shëndeti dhe mirëqenia e pjesëmarrësve në Projekt janë të një rëndësie të madhe. Duke pasur parasysh këtë prioritet, disa nga aktivitetet e parapara për këtë tremujor u shtynë. Më saktë, tre misione u shtynë për shkak të situatës me pandeminë botërore Covid-19, nga një mision për çdonjërin nga komponentët: 1, 2 dhe 4.

Gjithashtu, si rezultat i situatës, EUD pranoi propozimin e liderëve të Projektit për ndërprerjen e tij të përkohshme, ndoshta për tre muaj, duke filluar nga 1 prilli i vitit 2020.

#### **Kontakt:**

**Zyra e Këshilltarit të Përhershëm për Binjakëzim**  
**[twinning.nbrnm@gmail.com](mailto:twinning.nbrnm@gmail.com)**



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian



Ky publikim është përgatitur me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e BPRMV-së dhe në asnjë mënyrë nuk i reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.